

VENDIM
Nr. 755, datë 20.12.2023

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E MIRATUAR PËR VITIN 2023,
PËR DISA INSTITUCIONE TË PAVARURA TË KRIJUARA ME LIGJ**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të paragrafit të tretë, të shkronjës “a”, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2022, “Për buxhetin e vitit 2023”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Akordimin e një fondi shtesë, në zërin e shpenzimeve korrente, në masën 1 000 000 000 (një miliard) lekë, në buxhetin e miratuar për vitin 2023, për pagesën e një pjese të diferencës së pagës së magistratit, sipas arsyetimit të vendimin nr. 35, datë 22.11.2022, të Gjykatës Kushtetuese. Kjo diferencë jepet për institucionet e rivlerësimit kalimtar të magistratit, që nga momenti i krijimit të tyre dhe për institucionet e tjera të sistemit të drejtësisë, që nga data 1 janar 2019 e në vazhdim.

2. Fondi, sipas pikës 1, ndahet, si më poshtë vijon:

a) Për institucionin e Prokurorisë së Përgjithshme shtohet fondi prej 400 000 000 (katërqind milionë) lekësh;

b) Për institucionin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë shtohet fondi prej 10 000 000 (dhjetë milionë) lekësh;

c) Për institucionin e Këshillit të Lartë Gjyqësor shtohet fondi prej 350 000 000 (treqind e pesëdhjetë milionë) lekësh;

ç) Për institucionin e Strukturës së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar shtohet fondi prej 60 000 000 (gjashtëdhjetë milionë) lekësh;

d) Për institucionin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë shtohet fondi prej 2 000 000 (dy milionë) lekësh;

dh) Për institucionin e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit shtohet fondi prej 60 000 000 (gjashtëdhjetë milionë) lekësh;

e) Për institucionin e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit shtohet fondi prej 25 000 000 (njëzet e pesë milionë) lekësh;

ë) Për institucionin e Komisionerëve Publikë shtohet fondi prej 22 000 000 (njëzet e dy milionë) lekësh;

f) Për institucionin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve shtohet fondi prej 13 000 000 (trembëdhjetë milionë) lekësh;

g) Për institucionin e Avokatit të Popullit shtohet fondi prej 4 000 000 (katër milionë) lekësh;

gj) Për institucionin e Shkollës së Magjistraturës shtohet fondi prej 54 000 000 (pesëdhjetë e katër milionë) lekësh.

3. Fondi prej 1 000 000 000 (një miliard) lekësh përballohet nga fondi i kontingjencës, i miratuar në buxhetin e vitit 2023.

4. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe institucionet e përmendura në pikën 2 për zbatimin e këtij vendimi. Shlyerja e pagesës bëhet nga institucionet e sistemit të drejtësisë, brenda datës 15.1.2024.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama